



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Mbrojtje e Bimëve

Programi: Mbrojtje e Bimëve- Fitomedicinë

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Raza Krasniqi- Cakolli, me titull: **“Përmbajtja minerale e tatulles (*Datura stramonium L.*) në disa lokalitete të Kosovës”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 27/12/2023 deri me datë 02/01/2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Muhamet Zogaj, kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Mehmeti, mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Arben Mehmeti, përmes e-mail adresës arben.mehmeti@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

**FAKULTETI BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI MBROJTJA E BIMËVE
PROGRAMI MBROJTJA E BIMËVE-FITOMEDICINË**



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

”Përbërja minerale e tatulles (*Datura stramonium* L.) në disa lokalitetet të Kosovës”

Mentori:

Prof. Dr. Arben Mehmeti

Kandidatja:

Bsc. Raza Krasniqi

Prishtinë, Shtator 2023

Abstrakti

Datura stramonium (tatulla) është një ndër barojat shumë problematike në tokat bujqësore në vendin tonë. Rilevimet janë kryer gjatë vitit 2018, në katër lokalitete të ndryshme të Kosovës (Mitrovicë, Vushtrri, Gjilan dhe Viti), gjatë muajve korrik dhe gusht. Gjithsej janë kryer 20 rievime, nga 5 rievime për lokalitet.

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtohet përbërja minerale e *D.stramonium* në disa lokalitete të Kosovës. Gjithashtu janë hulumtuar edhe lloje tjera të barojave bashkëshoqëruese të *D.stramonium*. Bimët e *D.stramonium* nga katër lokalitete janë grumbulluar në kohë e zhvillimit të plotë, është matur lartësia e bimëve dhe është analizuar përbërja minerale (K, Ca, Mg, Na, Zn, Fe, Cu, Mn, Ni). Numri i llojeve të barojave bashkëshoqëruese në sipërfaqet e kultivuara me kultura bujqësore, ishte relativisht i pasur, gjithsej janë regjistruar 14 lloje të barojave.

Numri më i madh i bimëve të *D.stramonium* për 1 m² ishte në lokalitetin e Vushtrrisë, mesatarisht 14.4 bimë/m² dhe në lokalitetin e Mitrovicës 8 bimë/m². Në dy lokalitetet tjera numri i bimëve të tatulles ishte më i vogël, në lokalitetin e Vitisë 7.2 bimë/m² dhe në lokalitetin e Gjilanit ishte numër më i ulët me vetëm 6 bimë/m². Bimët e *D.stramonium* nga lokaliteti i Mitrovicës dhe Gjilanit ishin më të larta me lartësi mesatare 58.4 cm, respektivisht 57.3 cm në krahasim me dy lokalitetet e Vushtrris dhe Vitis.

Rezultatet për përmbajtjen e hekurit dhe zinkut në bimën e *D.stramonium* tregojn se ka dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet lokaliteteve, por jo edhe për mineralet tjera.

Fjalët kyçe: *Datura stramonium* L, gjethja, kërcelli, barojat bashkëshoqëruese.